Trusti
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS



BULETINI TREMUJOR
NR 67 -- VITI XVII -- TM3 2024

# TRUSTORJA

## PERFORMANCA - PORTOFOLI STANDARD

| PERIUDHA | 1 MUAJ | 3 MUAJ | VITI AKTUAL | 3 VJET | 5 VJET | NGA THEMELIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|
| REZULTATI | 1.51% | +2.92% | +7.17% | +8.64% | +20.24% | +79.66% |
| BENÇMARKU* | -0.31% | +0.15% | +0.23% | +17.79% | +22.92% | +70.16% |

**Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit sikurse i publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës.*

## LËVIZJET MUJORE - TRE PORTOFOLAT

| | NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË AKSIONIT | | | KTHIMI BRUTO **STANDARD** (MLN) | KTHIMI BRUTO **BALANCUAR** (MLN) | KTHIMI BRUTO **KONSERVATIV** (MLN) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| MUAJI | STANDARD | BALANCUAR | KONSERVATIV | | | |
| Korrik | +1.51% | +0.88% | +0.30% | €37.95 | €3.03 | €0.46 |
| Gusht | +0.62% | +0.78% | +0.29% | €16.47 | €2.80 | €0.45 |
| Shtator | +0.76% | +0.81% | +0.28% | €20.20 | €2.97 | €0.45 |
| **Tremujori** | **+2.92%** | **+2.49%** | **+0.87%** | **€74.62** | **€8.80** | **€1.36** |

## KONTRIBUIMI

| | KONTRIBUTET E REJA STANDARD (MLN) | LLOGARI TË REJA | LLOGARI AKTIVE | LLOGARI GJITHSEJ ** |
|---|---|---|---|---|
| Korrik | €29.75 | 4,048 | 411,104 | 857,147 |
| Gusht | €25.48 | 4,178 | 422,165 | 861,372 |
| Shtator | €18.79 | 3,026 | 429,500 | 864,398 |
| **Tremujori** | **€74.02** | **11,252** | **420,923*** | |

**Mesatarja tremujore*

***Kjo shifër i përfshin të gjitha llogaritë e hapura në FKPK nga themelimi e deri në datën e raportit.*

## PENSIONIMET

| | SHUMA E TËRHEQUR | TË PENSIONUAR | ARSYEJA E PENSIONIMIT | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | MOSHE | INVALIDITET | VDEKJE | TJERA |
| Korrik | €5,678,011 | 663 | 475 | 97 | 84 | 7 |
| Gusht | €3,923,807 | 495 | 369 | 45 | 78 | 3 |
| Shtator | €4,655,049 | 600 | 464 | 67 | 67 | 2 |
| **Tremujori** | **€14,256,867** | **1,758** | **1,308** | **209** | **229** | **12** |

# PËRMBLEDHJE SHIFRASH SIPAS TREMUJORËVE PËR VITIN 2024

| | FUNDI TM1 | FUNDI TM2 | FUNDI TM3 | FUNDI TM4 |
|---|---|---|---|---|
| ÇMIMI I AKSIONIT **STANDARD** | €1.7438 | €1.7457 | €1.7966 | |
| ÇMIMI I AKSIONIT **BALANCUAR** | -- | €1.0086 | €1.0338 | |
| ÇMIMI I AKSIONIT **KONSERVATIV** | €2.1479 | €2.1665 | €2.1853 | |
| | | | | |
| KTHIMI BRUTO NGA INVESTIMET PËR TREMUJOR **STANDARD** (në milionë) | €107.06 | €5.23 | €74.62 | |
| KTHIMI BRUTO NGA INVESTIMET PËR TREMUJOR **BALANCUAR** (në milionë) | -- | €3.23 | €8.80 | |
| KTHIMI BRUTO NGA INVESTIMET PËR TREMUJOR **KONSERVATIV** (në milionë) | €1.21 | €1.31 | €1.36 | |
| | | | | |
| MNM* **STANDARD** | €2,727,371,317 | €2,456,574,225 | €2,560,788,446 | |
| MNM* **BALANCUAR** | -- | €332,013,233 | €360,226,844 | |
| MNM* **KONSERVATIV** | €134,584,509 | €140,028,867 | €146,674,276 | |
| | | | | |
| LLOGARI GJITHSEJ | 843,360 | 853,061 | 864,398 | |
| LLOGARI AKTIVE | 343,419 | 399,585 | 429,500 | |
| | | | | |
| TARIFA INVESTUESE **PËR TREMUJORIN**** | €2,134,540 | €2,223,816 | €2,330,280 | |
| TARIFA OPERACIONALE **PËR TREMUJORIN**** | €330,510 | €344,333 | €360,818 | |
| | | | | |
| INVESTIMET NË KOSOVË | €600,527,742 | €643,360,445 | €589,163,597 | |
| INVESTIMET JASHTË | €2,263,738,780 | €2,286,578,261 | €2,480,934,960 | |

MNM* - *Mjetet Neto nën Menaxhim*

** - *Përfshihet tarifa e tre portofolave: Standard - Balancuar - Konservativ*

## PLASMANET DHE PERFORMANCA NË FUND TË TM3 2024

| MENAXHUESI \|\| FONDI \|\| INSTITUCIONI | NUMRI ISIN \|\| LLOJI INVESTIMIT | PLASMANET FUNDI I TM3 2024 | KTHIMI BRUTO NË INVESTIME (PËR TREMUJORIN) |
|---|---:|---:|---:|
| Amundi 3 MI | FR0007038138 | €368,725,697.62 | €5,506,605.84 |
| iShares MSCI GM ETF | IE00BQN1K901 | €100,289,854.66 | €4,211,820.34 |
| iShares R&M RE ETF | US4642885622 | €30,898,569.83 | €3,041,314.40 |
| iShares US Infrastructure | US46435U7138 | €74,341,155.23 | €4,968,752.14 |
| Nordea 1-GSEF | LU0257969260 | €178,817,801.51 | €9,978,053.60 |
| Nordea 1-SRF | LU0539147214 | €244,105,961.37 | €14,341,626.10 |
| Pacer Data&Infras. ETF | US69374H7411 | €26,759,415.02 | €3,088,256.63 |
| SPDR MSCI Energy ETF | IE00BKWQ0F09 | €30,496,752.00 | €(3,561,135.84) |
| SPDR S&P DA ETF | IE00B5M1WJ87 | €24,271,471.52 | €931,238.64 |
| SPDR S&P Oil&Gas ETF | US78468R5569 | €52,778,615.44 | €(7,966,802.79) |
| Global X US Infrastr. | US37954Y6730 | €75,364,837.63 | €4,856,930.74 |
| Vanguard Value ETF | US9229087443 | €71,141,263.12 | €3,069,468.11 |
| Vanguard Eurozone ETF | IE00BH04GL39 | €27,294,359.13 | €1,074,760.96 |
| Vanguard GSIF | IE00B03HD316 | €584,209,809.81 | €21,418,341.52 |
| WisdomTree WTI | GB00B15KXV33 | €23,876,253.77 | €(4,051,720.46) |
| Invesco S&P 500 UCITS | IE00BRKWGL70 | €282,132,016.33 | €12,469,416.33 |
| SPDR Russel 200 UCITS | IE00BJ38QD84 | €28,649,709.00 | €1,363,356.11 |
| Amundi MSCI Japan | LU2133056387 | €41,220,223.00 | €(2,738,281.31) |
| Amundi MSCI Europe | LU1681041890 | €41,422,058.10 | €300,774.20 |
| Schroders ISF | LU2802595350 | €113,414,924.52 | €5,655,627.34 |
| Thesari i Kosovës | Letra me vlerë të Kosovës | €500,841,309.56 | €4,179,094.01 |
| Banka në Kosovë | Depozita bankare | €134,697,788.58 | €1,130,140.52 |
| BQK - të gatshme | Të painvestuara | €12,532,228.86 | €17,600.11 |
| Erste Bank (Broker) | Të painvestuara | €1,780,356.10 | €14,304.72 |
| StoneX (Broker) | Të painvestuara | €848.02 | -- |
| Të arkëtueshme | -- | €35,277.17 | -- |
| Dividendat | -- | -- | €1,476,603.58 |
| **GJITHSEJ** | | **€3,070,098,556.90** | **€84,776,145.54** |

# LAJME

| | |
|---|---|
| **INVESTIMET E FKPK-SË ME NGRITJE EDHE PËR TM3 2024** | Edhe tremujori i tretë i 2024-së u përmbyll me ngritje të vlerës së mjeteve të investuara. Tre portofolat investues të FKPK-së dolën pozitivë për TM3 sikurse në vijim:<br><br>1) Portofoli Standard me +2.9% (i grupmoshës 16-57 vjeç);<br>2) Portofoli i Balancuar me +2.5% (i grupmoshës 58-62 vjeç) dhe<br>3) Portofoli Konservativ me +1.2% (i grupmoshës 63 vjeç e sipër).<br><br>Megjithatë, edhe pse ky tremujor u përmbyll kënaqshëm pozitivisht, ai u karakterizua me luhatshmëri më të lartë të tregjeve financiare nga sa pritej.<br><br>Analizuar gjithë tremujorin: muaji korrik ishte pa luhatje të forta, dhe kryesisht me ngritje, në fillim të muajit gusht tregjet financiare pësuan rënie të shpejtë dhe të fortë. Kjo erdhi nga frika e ngadalësimit ekonomik në SHBA dhe nga zbehja e treguesve të punësimit atje, por edhe nga luhatja e fortë të valutës së Japonisë. Rikuperimi nga kjo gjendje fatmirësisht ishte tejet i shpejtë, duke bërë që FKPK-ja të kapte ngritje prej +4.4% në fund të muajit gusht.<br><br>Porse fundi i këtij tremujori u karakterizua nga lehtësimi i politikave monetare në SHBA (në muajin shtator), përmes uljes së normave të interesit dhe duke ndikuar kështu pozitivisht në ngritjen e kërkesës për investime në tregun e aksioneve. Ndërsa vlerësuar për vitin aktual, FKPK-ja ka grumbulluar një kthim bruto nga investimet prej rreth 200 milionë euro për periudhën 1 janar e deri më 30 shtator 2024, vlerë kjo e akumuluar nga të tre portofolat e mësipërm investues.<br><br>Sikurse e kemi shpjeguar në publikimet tona të rregullta, FKPK-ja ekspozohet në mbi 1 mijë entitete në investimet e saja në tregjet financiare ndërkombëtare. |
| **ARRIHET VLERA 3 MILIARDË EURO NËN MENAXHIM** | Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës e arriti për herë të parë vlerën e 3 miliardë eurove të mjeteve neto nën menaxhim në fundgusht të 2024-s.<br><br>Gjatë periudhës janar-gusht 2024 mjetet nën menaxhim u ngritën për më shumë se €300 milionë krahasuar me fundvitin 2023. Kjo ngritje erdhi nga kontributet e reja (rreth €200 milionë) dhe kthimi nga investimet (rreth €165 milionë). Por njëkohësisht rreth €60 milionë u zbritën nga fondi për pagesat mujore të pensioneve dhe shpenzimet e tjera.<br><br>Prej fillimit të operimit të FKPK-së (më 2002), një-miliardëshi i parë i mjeteve neto nën menaxhim është arritur më 2014 ndërsa dy-miliardëshi më 2021. Vlerësuar në tërësi, mjetet që FKPK-ja i ka aktualisht nën menaxhim përbëhen prej pagesave të kursimeve pensionale nga kontribuuesit (rreth 78% ose €2.34 miliardë) dhe kthimi nga investimet (rreth 22% ose €660 milionë). |
| **REALIZOHET RIMBURSIMI I 10%-SHIT PËR TË PENSIONUARIT E 2024-S** | Qeveria e Kosovës më 26 korrik 2024 e ka paguar këstin e dytë për rimbursimin e 10%-shit për kontribuuesit që i kishin të grumbulluara deri në 9,999 euro në llogarinë e FKPK-së në momentin e aplikimit për tërheqjen e parakohshme të 10%-shit. Prioriteti i rimbursimit të kontribuuesve përcaktohet me memorandumin e bashkëpunimit në mes të FKPK-së dhe Qeverisë së Kosovës.<br><br>Për vitin 2024 Qeveria e Kosovës i ka rimbursuar 1,873,875.75 euro për gjithsej 4,255 pjesëmarrës, të cilët: (a) këtë vit e arrijnë moshën e pensionimit 65 vjeçare (pra janë të lindur në vitin 1959), ose (b) kanë vdekur, dhe kursimet e tyre janë tërhequr nga trashëgimtarët e tyre (që nga rimbursimi i vitit 2023).<br><br>Në këtë datë të raportimit, me tërheqje kursimesh ishin 2,464 pjesëmarrës (me shumë të riimbursuar 1.17 milionë euro); dhe për ta FKPK-ja më 31 korrik 2024 e ka kryer bartjen, e 10%-shit të rimbursuar, në llogaritë bankare përkatëse (në llogarinë e kursimeve për pjesëmarrësit në programin e tërheqjes në faza ose në llogarinë rrjedhëse për personat me tërheqje të menjëhershme kursimesh). |

**PUBLIKON**

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
Tetor 2024

**AUTOR**
Jeton Demi

**ADRESA**
Rr. "Agim Ramadani" #182-184 10000 Prishtinë, Kosovë

**E-MAIL & UEB**
info@trusti.org | www.trusti.org

**FACEBOOK**
TrustiPensional

**YOUTUBE**
Fondi Pensional i Kosovës